

2006 vende për studimet master

PRISHTINË. Universiteti i Prishtinës (UP) ka shpallur të hapur konkursin për pranimin e studentëve në studimet postdiplo-mike-master. Për këtë vit akademik UP-ja ka vendosur të regjistrojë në këto studime 2006 studentë të rregullt. Ndërkohë kriteret për pranimin e studentëve në këtë nivel studimesh vazhdojnë të mbesin të njëjta me vitet e mëparshme. Nota mesatare prej 7.50 e paraparë si prag i kalueshmërisë për klasifikim në fakultetet ku konkurrenca është sa numri i kërkuar me konkurs,



vazhdon të mbetet në fuqi si rregull për pranimin e kandidatëve, ndërsa mesatarja e notave nën këtë prag iu krijon mundësinë kandidatëve të pranohen në drejtimet ku konkurrojnë pasi t'i nënshtrohen provimit pranues.

Edhe në studimet master me

numrin më të madh të vendeve për konkurrim qëndrojnë Fakulteti Ekonomik dhe ai Juridik. Në këto dy fakultete do të regjistrohen nga 400 studentë. Përdërisa në dy drejtime të Juridikut; në drejtimin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe në drejtimin civilo-juridik për të fituar të drejtën e konkurrimit kandidatët duhet të njohin gjuhën angleze. Këto dy programe janë inkuadruar në plan-programet e masterit si projekte të organizatës për ndihmë arsimit 'Wus Austria'. **ANITA KADRIU**

13, 10, 2010, "Zëri"